**4.15.** T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

**5.** Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

**5.1.** Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe

**5.2.** Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njesia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4496 Nr. i faq/Br.str/No.pg 153
Data/Datum/Date 19/7/24

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, nenit 9 dhe nenit 10 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 1427, e datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë, në këtë përbërje:
   1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
   1.2. Fiknete Kasapi - Iska, anëtare,
   1.3. Fjolla Duraku, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të bursave për studentë, sipas dispozitave të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve, Nr. 1427, të datës 28.4.2017.

3. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas përfundimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesave.

4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 1427, të datës 28.4.2017 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe në Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

5. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë, mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kritereve të përcaktuara me Rregullore për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

6. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë ka mandat 3 (tre) - vjeçar.

7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Arsim.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/2245, i datës 9.6.2022, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin me Nr. Prot. 02/944/2023, i datës 4.7.2023.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtoria për Arsim, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia/Jedinica/Unit 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr. 4502 Nr. i faq/Br.str/No.pg 154
Data/Datum/Date 22 / 7 / 2024
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Bartja e të moshuarve dhe funksionalizimi i shtëpisë për të moshuar, Lot 1-Bartja e të moshuarve në relacionin Rahovec-Shtëpia për të moshuar dhe anasjelltas-Ritenderim", me Nr. prokurimi: 623-24-7216-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-044-2-3-6, të datës 22.7.2024, në këtë përbërje:

   **1.1.** Faik Thaqi, kryesues,
   **1.2.** Enise Dina, anëtare,
   **1.3.** Vjollca Berisha, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Bartja e të moshuarve dhe funksionalizimi i shtëpisë për të moshuar, Lot 1-Bartja e të moshuarve në relacionin Rahovec-Shtëpia për të moshuar dhe anasjelltas-Ritenderim", me Nr. prokurimi: 623-24-7216-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-044-2-3-6, të datës 22.7.2024.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opŝtine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4511 Nr. i faq/Br.str/No.pg 155
Data/Datum/Date 24 / 7 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2024-2028**

1. **Caktohet** grupi punues për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2024-2028, në këtë përbërje:
   1.1. Albnor Mullabazi, kryesues,
   1.2. Përparim Krasniqi, anëtar,
   1.3. Besmire Bytyçi, anëtare,
   1.4. Arbër Zenuni, anëtar,
   1.5. Metush Isma, anëtar,
   1.6. Zyber Thaqi, anëtar,
   1.7. Mentor Veliu, anëtar,
   1.8. Vjollca Gurgule, anëtare,
   1.9. Murat Morina, anëtar,
   1.10. Bjondina Ramaj, anëtare,
   1.11. Afrim Hoti, anëtar.

2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Planin Lokal për Veprim në Mjedis 2024-2028.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe në aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet grupi punues që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Vendimi u dërgohet:*

- ***Anëtarëve të grupit punues,***
- ***Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4512 Nr. i faq/Br.str/No.pg 155
Data/Datum/Date 24/7/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] me Nr. Protokolit 06-553/01-0028329/24, e dt. 22.07.2024 për ndihmë financiare prej 500.00€ (peseqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

[redacted] nga Rahoveci me datë 22.07.2024 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 16.07.2024 ka lindur [redacted] në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI - RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4513 Nr. i faq/Br.str/No.pg 155
Data/Datum/Date 24/7/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 75, paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. **GENTIANA MORINA** nga fshati Gexhë, komuna e Rahovecit, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar për Gjendje Civile, në zyrën e vendit në Krushë të Madhe, në Drejtorinë për Administratë, **I PËRFUNDON marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil,** nga data 19.7.2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**GENTIANA MORINA** nga fshati Gexhë, komuna e Rahovecit, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar për Gjendje Civile, në zyrën e vendit në Krushë të Madhe, në Drejtorinë për Administratë. Zyrtarja Gentiana Morina, përmes kërkesës për dorëheqje, u është drejtuar Njësisë së Personelit dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë, z. Besnik Hoti, me kërkesë për dorëheqje, të datës 18.7.2024, se ajo ka dhënë dorëheqje nga marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, për arsye familjare.

Sipas nenit 75, paragrafi 1, i Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon kur nëpunësi civil jep dorëheqje nga detyra.

Prandaj, kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve mbi gjendjen reale, vendos si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi, pala ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**Me vendim të njoftohen:**

- Gentiana Morina,
- Drejtoria për Administratë,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Dosja personale, dhe
- Arkivi.

**Smajl Latifi**
Kryetar i Komunës

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna Rahovec*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4514 Nr. i faq/Br.str/No.pg 155
Data/Datum/Date 24/7/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008")*, nenit 4, paragrafi 5 të Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22, e datës 31.5.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës për humanizëm "Dr. Ali Sokoli"**

**1.** Caktohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës për humanizëm "Dr. Ali Sokoli", në këtë përbërje:

**1.1.** Elbunit Kryeziu, kryesues,
**1.2.** Qemajl Krasniqi, anëtar,
**1.3.**Ardian Rama, anëtar.

**2.** Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha propozimeve, si dhe përzgjedhjen e personalitetit për dhënien e dekoratës për humanizëm "Dr. Ali Sokoli", duke u bazuar në Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit, me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22, e datës 31.5.2022.

**3.** Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 7.8.2024, kur edhe do t'i rekomandojë kryetarit të Komunës personalitetin e vitit për dhënien e dekoratës.

**4.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

**5.** Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4524 Nr. i faq/Br.str/No.pg 156
Data/Datum/Date 29/7/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

**1.** Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi i ballkonit panoramik mbi qytetin e Rahovecit", me numër të kontratës: 623-24-5662-5-2-1/C597, si në vijim:

1.1."P.M.N." Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2. Albnor Mullabazi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

**2.** Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit te Menaxheri i Kontratës.

**3.** Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
**3.1.** Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
**3.2.** Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
**3.3.** Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

**4.** Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
**4.1.** Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

**4.2.** Menaxheri i kontratës, duhet te lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;

**4.3.** Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblerjen;

**4.4.** Pas pranimit te urdhërblerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;

**4.5.** Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.6.** Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.7.** Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.8.** Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;

**4.9.** Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;

**4.10.** Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;

**4.11.** Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.12.** T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;

**4.13.** Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;

**4.14.** T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe

**4.15.** T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

**4.** Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

**5.1.** Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe

**5.2.** Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4525 Nr. i faq/Br.str/No.pg 156
Data/Datum/Date 30 / 7 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i serrave për fermerë, me participim 80%-20%", me Nr. prokurimi: 623-24-6885-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 623-24-049-5-2-1, të datës 29.7.2024, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jetmir Ukaj, kryesues,
   **1.2.** Bahrije Çmega, anëtare,
   **1.3.** Egzon Thaqi, anëtar,
   **1.4.** Enise Dina, anëtare,
   **1.5.** Bekim Krasniqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i serrave për fermerë, me participim 80%-20%", me Nr. prokurimi: 623-24-6885-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 623-24-049-5-2-1, të datës 29.7.2024.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4539 Nr. i faq/Br.str/No.pg 157
Data/Datum/Date 30 / 7 / 24

Komisioni Komunal për Riintegrim , bazuar në nenin 13 te ligjit për vetëqeverisje lokale dhe neni 44, nën paragrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 2 dhe 4, dhe neni 33, paragrafi 1, nenparagrafi 1.11, paragrafi 2 dhe 6, andaj u vendos si në dispozitivin të Rregullores të QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, mbështetur në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit Nr. 271 te datës 14.07.2014 për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr:

## V E N D I M

1. APROVOHET kërkesa e [redacted] kthyer me dt. 17.06.2024 me dhunë, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegrimit për akomodimi për 12 muaj,**per here te pare** nga data 01.08.2024 deri me 31.07.2025, në vlerë 280 Euro per çdo muaj, duke i përfshirë edhe shpenzimet komunale, sipas kërkesës me nr. 2031 datë 02/07/2024 të parashtruar në ZKKK në Komunën e Rahovecit dhe sipas ofertës më të lirë.

2. Përfitues nga pika 1 e këtij vendimi është familja tre (1) anëtarëshe nga komuna e Rahovecit

3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Ministria e Punëve te Brendshme.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim, në seancën e mbajtur më datë 30.07.2024, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar me datë 02.07.2024 nga [redacted] në Komunën e Rahovecit për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegrimit, për akomodim me qira, duke u bazuar në rekomandimet e Zyrës Komunale për Kumunitete dhe Kthim.
Përfituesi po përballet me një situatë të rëndë socio-ekonomike dhe është në kërkim të strehimit të përkohshëm. [redacted] pavarësisht se është nga Rahoveci, ka kërkuar strehim në Gjakovë për shkak të një situate të ndërlikuar familjare. Para luftës, familjarët e tij u larguan nga Rahoveci për shkak të një nderlikimi në gjakmarrje , dhe ai ende ka frikë nga pasojat e mundshme në rast të kthimit. Situata e tij kërkon një zgjidhje të përhershme për strehim në Gjakovë.

**Sipas rregullorës së paraparë, kërkesa për akomodim me qira i aprovohet për periudhën 12 mujore nga 01.08.2024 deri me 31.07.2025, në vlerë 280 € në muaj, për të vazhduar procesi i trajtimit të statusit të tij më tutje për mbështetje nga niveli komunal.**

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezentuara, dhe sipas dëshmive të paraqitura, konstaton se i riatdhesuari i **plotëson kriteret** për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegrimit, për akomodim me qira të përcaktuar me Rregulloren QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e përsonave të Riatdhesuar, neni 44, nën paragrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 2 dhe 4, dhe neni 33, paragrafi 1, nenparagrafi 1.11, paragrafi 2 dhe 6, andaj u vendos si në dispozitivin

**Këshillë juridike :**

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur në afat prej 30 (tridhjet) ditësh pas pranimit të tij, mund të paraqes ankesë në Komisionin e Ankesave.

Rahovec, 30.07.2024

**Kopja e vendimit i dërgohet**:

**1.**[redacted]
**2.**Koordinatorit Rajonal të MPB,
**3.**Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete,
**4.**Arkivit të Komunës.

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr./Br./No. 4532 Nr. i faq./Broj/No.pg. 157
Data/Datum/Date 31.7.24
RAHOVEC

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1.1, lidhur me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme të datës 26.03.2009 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/2009")* dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010, në mbështetje të nenit 44 dhe nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016")* dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve brenda afatit ligjor, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M P R E L I M I N A R**
**Mbi ligjshmërinë e shpronësimit të propozuar**

1. **MIRATOHET** kërkesa e subjektit kërkues, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik për vendosjen e trafos elektrike në lagjen "Vëllezërit Frashëri" në Rahovec, si vijon:
   - Pjesën e parcelës P-71510057-01728-1 në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej $9m^2$ (nëntë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej $430m^2$ (katërqind e tridhjetë metra katror) në vendin e quajtur *strane*, me kulturë: Kullosë e klasës II, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në emër të Agim (Xhafer) Kastratit.

2. Vërtetohet se vendosja e trafos elektrike në lagjen "Vëllezërit Frashëri" në Rahovec, është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe që shpronësimi i paluajtshmërisë së lartcekur është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Pronari i parcelës kadastrale të cekur në pikën **1** të këtij vendimi, do të kompensohet konform dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ndryshim-plotësimit të Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-205, i datës 10.12.2010.

4. Vendimin preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t'ia dërgojë zotëruesit të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se iu takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës, pas miratimit të vendimit preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në një gazetë zyrtare me tirazh më të madh, në Republikën e Kosovës dhe ky vendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

Subjekti kërkues – Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit, me kërkesën me Nr. Prot. 2180, të datës 11.7.2024, ka kërkuar inicimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik për vendosjen e trafos elektrike në lagjen "Vëllezërit Frashëri" në Rahovec.

Subjekti kërkues i kësaj kërkese ia ka bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm i cili parashihet me dispozitën e nenit 8 lidhur me nenin 4 të Ligjit mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Organi shpronësues, pas shqyrtimit të kërkesës, ka ardhur në përfundim se shpronësimi i paluajtshmërisë së evidentuar në dispozitiv të këtij vendimi preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njëjtit qëllim dhe që shpronësimi në fjalë nuk prek të drejtat private, se pjesa e pronës së paluajtshme, e cila është objekt shpronësimi, nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimit diskriminues dhe se organi shpronësues lidhur me këtë çështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

Organi shpronësues – kryetari i Komunës, me vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim me Nr. Prot. 2180, të datës 11.07.2024, ka miratuar kërkesën e subjektit kërkues – Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Rahovecit për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik.

Po ashtu, organi shpronësues, në bazë të nenit 4 dhe nenit 10 të këtij Ligji, brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, shpall në gazetë zyrtare me tirazh më të madh, në Republikën e Kosovës.

Vendimin preliminar, organi shpronësues, brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, do t'ia dërgojë pronarit, zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë që pretendojnë se u takon ndonjë e drejtë në pjesën e parcelës së shpronësuar në bazë të nenit 10, paragrafi 3 të këtij ligji.

Prandaj, duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për inicimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkues është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzim Juridik:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, në afat prej 15 ditëve kalendarike, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Subjektit kërkues – DGJKP-ja,***
- ***Pronarit dhe zotëruesit e interesit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS - ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No.02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4533 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 157
Data/Datum/Date 31/7/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 21 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civilë, Nr.03/L-147, të datës 13.5.2010 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 33/2012, për shtesat në pagat dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civilë, neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
## PËR LEJIMIN E PAGESËS PËR PUNË JASHTË ORARIT TË PUNËS

1. Me këtë vendim, **LEJOHET** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për **Ajet Sahitajn,** i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: Zyrtar i Gjendjes Civile në Çifllak, Drejtoria për Administratë në Komunën e Rahovecit.

2. Vlera e pagesës për punë shtesë **jashtë orarit të punës** është **30 (tridhjetë euro)** për kryerjen e punës, respektivisht kurorëzimit **jashtë objektit të komunës së Rahovecit,** i cili më datë **22.6.2024,** në ceremoninë e martesës, ka kryer lidhjen e kurorëzimit të çiftit **Visar Morina** dhe **Fitore Malushi.**

3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt të punës sigurohen nga kodi: Paga dhe Mëditje.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

*A r s y e t i m*

Me kërkesën e **Ajet Sahitajt,** i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: Zyrtar i Gjendjes Civile në Çifllak, në Drejtorinë për Administratë, në Komunën e Rahovecit dhe me autorizimin e drejtorit për Administratë, të datës 21.6.2024, punëtori i lartcekur ka marrë pjesë më **22.6.2024** në kurorëzimin të shtetasve të Republikës së Kosovës, jashtë objektit të komunës së Rahovecit, prandaj për shkak të kryerjes së punës - lidhjes së kurorëzimit **jashtë objektit të komunës së Rahovecit** dhe **jashtë orarit të punës,** duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, është e domosdoshme që të bëhet pagesa për kryerjen e punës.

***Me vendim të njoftohen:***

- *Ajet Sahitaj, zyrtar i Gjendjes Civile në Çifllak,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyra e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4537 Nr. i faq/Br.str/No.pg 157
Data/Datum/Date 31 / 7 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që, znj. Njomëza Fazliu, e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, në Drejtorinë për Financa dhe Buxhet në Rahovec, ta përfshijë në listat e pagave me pagë të plotë mujore nga data 30.7.2024.

2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Vendimi iu dorëzohet:**
1. Njomëza Fazliut,
2. Drejtorisë për Financa dhe Buxhet,
3. Njësisë së Personelit, dhe
4. Arkivit.

Smajl Latifi

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4539 Nr. i faq/Br.str/No.pg 157
Data/Datum/Date 31 / 7 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

**1.** Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore", me numër të kontratës: 623-24-3803-5-2-1/C598, si në vijim:

1.1."P.M.N." Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

**1.2.** Berat Duraku, drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

**2.** Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit te Menaxheri i Kontratës.

**3.** Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
**3.1.** Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
**3.2.** Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
**3.3.** Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

**4.** Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
**4.1.** Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

**4.2.** Menaxheri i kontratës, duhet te lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;

**4.3.** Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblerjen;

**4.4.** Pas pranimit te urdhërblerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;

**4.5.** Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.6.** Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.7.** Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.8.** Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;

**4.9.** Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;

**4.10.** Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;

**4.11.** Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.12.** T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;

**4.13.** Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;

**4.14.** T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe

**4.15.** T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

**5.** Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

**5.1.** Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe

**5.2.** Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA – KOMUNA E RAHOVECIT – ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna Rahovec*

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4540 Nr. i faq/Br.str/No.pg 157
Data/Datum/Date 31 / 7 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 40 të Ligjit Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

# V E N D I M

1. Formohet komisioni i rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimit në punë të një: Zyrtar për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Tatimin në Pronë, në Drejtorinë për Financa dhe Buxhet, sipas konkursit me RN00014361, në këtë përbërje:
   1. Njomëza Fazliu, kryesuese,
   1.1. Qëndresa Kryeziu - Hoxha, zëvendësuese,
   2. Asllan Mazreku, anëtar,
   2.1. Fidan Hoti, zëvendësues,
   3. Ekrem Bytyqi, anëtar,
   3.1. Esat Hoti, zëvendësues,
   4. Agron Thaqi, anëtar,
   4.1. Antigona Krasniqi, zëvendësuese,
   5. Shqipe Tara, anëtare
   5.1. Habibe Haxhimustafa, zëvendësuese.

2. Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës